
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____._____.2025

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË
AFATET E ANKIMIMIT**

24.09.2025

Drejtuar: Operatorit Ekonomik “MEDFAU” shpk, me NUIS: **J93610823R**, me adresë: *Tirane
Kavaje KAVAJE LAGJA 5.*

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: Mallra

Lloji i Procedurës së prokurimit: E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, Kontratë.

Referenca e Lotit: REF-56502-07-29-2025.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje Gazkromatograf Bidimensional për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave”, me fond limit: 16,956,000 (gjashtëmbëdhjetë milion e nëntëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë) lekë pa TVSH, me afat zbatimi brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga dita e nënshkrimit të kontratës.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 30.07.2025.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletin e Njoftimeve Publike: Buletini Nr. 40 datë 4 Gusht 2025.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☒

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “PEGASUS.” SH.P.K

J62903750A

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: 7,780,000 (shtatë milion e shtatëqind e tetëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. “BionicTech” SH.P.K

M41406021N

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: 10,900,000 (dhjetë milion e nëntëqind mijë) Lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. “KRIJON” SH.P.K

K12023001A

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: 10,900,000 (dhjetë milion e nëntëqind mijë) Lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4. “MEDFAU” SH.P.K

J93610823R

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: 12,900,000 (dymbëdhjetë milion e nëntëqind mijë) Lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____
(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. “PEGASUS.” SH.P.K

J62903750A

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: 7,780,000 (shtatë milion e shtatëqind e tetëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____
(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Operatori ekonomik “PEGASUS” sh.p.k, me Nuis J81609010U nuk përmbushi kërkesat për kualifikim sipas pikës 2, të Seksionit 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar, Kërkesat e Vecanta për Kualifikim , Shtojca 8 e DT, në lidhje me detyrimin për paraqitjen e raporteve të auditit ligjor të pasqyrave financiare të viteve 2022 dhe 2024, si më poshtë vijon:

Në Pikën 2, Seksioni 2.2 Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar , Shtojca 8 e DT është kërkuar “Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2022, 2023, 2024) të konfirmuara nga autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë **bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore**”, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.

Për këtë pikë subjekti “PEGASUS” sh.p.k, nuk paraqiti raportet e auditit ligjor të pasqyrave financiare vjetore për vitet 2022 dhe 2024 megjithëse këto dokumentet janë përcaktuara shprehimisht në dokumentat e tenderit si dokumente të detyrueshme për kualifikim për tu paraqitur.

Konkretisht referuar pasqyrave financiare të paraqitura për vitet 2023 dhe 2024 “PEGASUS” sh.p.k, për dy vite rradhazi plotësonte dy nga tre kushtet kumulative të përcaktuara në nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar:

a). totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh;

PEGASUS sh.p.k në vitin 2023 rezulton me aktive 2,165,000,000(dy miliard e njëqind e gashtëdhjetë e pesë milion) lekë .

PEGASUS sh.p.k në vitin 2024 rezulton me aktive 2,259,214,000(dy miliard e dyqind e peëdhjetë e nëntë milion e dyqind e katërmbëdhjetë) lekë

b)ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh; iii. ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël.”

PEGASUS sh.p.k në vitin 2023 rezulton me qarkullim financiar 1,276,358,299 (një miliard e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë milion e treqind e pesëdhjetë e tetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë .

PEGASUS sh.p.k në vitin 2024 rezulton me aktive 1,468,044,134 (një miliard e katërqind e gjashtëdhjetë e tetë milion e dyzetë e katër mijë e njëqind e tridhjetë e katër)lekë

Sqarojmë se për të justifikuar mungesën/mosparaqitjen e raport auditit ligjor për pasqyrat financiare 2024 PEGASUS sh.p.k ka paraqitur një shkresë nga subjekti S and E LAZE AUDIT sh.p.k të titulluar “Vërtetim”, dokument i datës 27.03.2025 ku kjo kompania audituese deklaron se *pasqyrat financiare pr vitin 2024 të PEGASUSU sh.p.k i janë nënshktruar audititi ligjor dhe janë ende në proces auditimi, por ky dokument nuk justifikon mungesën e dokumentiti ligjor të kërkuar për dy arsye*

Se pari, dokumenti mban datën 27.03.2025 ndërkohë ofertat në këtë procedurë prokurimi janë hapur në datën 28.08.2025 pra dokumenti nuk ka asnjë lidhje me kohën e zhvillimit të procedurës që është njoftimi i kontratws data 30.07.2025 deri nw hapjen e ofertave datw 28.08. 2025.

Së dyti afati ligjor për detyrimin e depozitimit të pasqyrave financiare të vititi parardhës 2024 (Neni 46 i ligji 9723 datë 03.05.2007 (i ndryshuar) është data 31.07.2025 dhe për këtë arsye afati i auditimit i pasqyrave financiare 2024 ka përfunduar dhe duhet të ishin dorëzuar bashkë me bilancin e vitit 2024, sipas kërkesës në pikën 2 të Seksionit 2.2 “Kapaciteti ekonomikdhe financiar“
Në zbatim të rregullave në Shtojcën 8 , Kërkesat e Vecanta për Kualifikim, paragrafi i fundit ku përcaktohet “Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim”, oferta e subjektit PEGASUS sh.p.k refuzohet për mosparaqitjen e dokumenteve të kërkuara mbi raportin e auditeve financiar për bilancet e viteve 2022 dhe 2024.

2. “BionicTech” SH.P.K

Emri i plotë i shoqërisë

M41406021N

Numri i NIPT-it

Vlera: 10,900,000 (dhjetë milion e nëntëqind mijë) Lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

I. Operatori ekonomik “BionicTech ” sh.p.k., me Nipt M41406021N nuk përmbushi kërkesat për kualifikim **sipas pikës 2, të Seksionit 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar**, Kërkesat e Vecanta për Kualifikim , Shtojca 8 e DT, në lidhje me detyrimin për paraqitjen e pasqyrave financiare të vitit 2024, si më poshtë vijon:

Në Pikën 2, Seksioni 2.2 Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar , Shtojca 8 e DT është kërkuar **“Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2022, 2023, 2024) të konfirmuara nga autoriteteve përkatëse tatimore.**

Për këtë pikë subjekti “BionicTech” sh.p.k, nuk paraqiti kopje të certifikuar të bilancit/pasqyrave financiare për vitin 2024, i cili figuron edhe viti i vetëm financiar kur ky subjekt ka kryer aktivitet tregtar.

II. Operatori ekonomik “BionicTech” sh.p.k., me Nipt M41406021N nuk përmbushi kërkesat për kualifikim sipas pikës 2, të Seksionit 2.3 “Kapaciteti teknik”, Kërkesat e Vecanta për Kualifikim, Shtojca 8 e DT, në lidhje me detyrimin për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose autorizimit nga distributorit të autorizuar për tregtimin e aparaturave, si më poshtë vijon:

Në Pikën 2, Seksioni 2.2 Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar, Shtojca 8 e DT është kërkuar **“Operatori ekonomik duhet të dorëzojë Autorizim/Marrëveshje me prodhuesin/distributorin e autorizuar nga prodhuesi për artikullin objekt prokurimi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: (telefon, fax, e-mail, website) të nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.**

Për këtë pikë subjekti “BionicTech” sh.p.k, nuk paraqiti autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për tregtimin e aparaturave dhe në zbatim të rregullave në Shtojcën 8, Kërkesat e Vecanta për Kualifikim, paragrafi i fundit ku përcaktohet “Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim”, oferta e subjektit BionicTech sh.p.k refuzohet.

3. “KRIJON” SH.P.K

K12023001A

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: 10,900,000 (dhjetë milion e nëntëqind mijë) Lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve, Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Operatori ekonomik “KRIJON” sh.p.k., me Nipt K12023001A nuk përmbushi kërkesat për kualifikim sipas pikës 2, të Seksionit 2.2. “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, Kërkesat e Vecanta për Kualifikim, Shtojca 8 e DT, në lidhje me detyrimin për paraqitjen e raporteve të auditit ligjor të pasqyrave financiare të vitit 2024, si më poshtë vijon:

Në Pikën 2, Seksioni 2.2 Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar, Shtojca 8 e DT është kërkuar **“Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuar të bilanceve të viteve: (2022, 2023, 2024) të konfirmuara nga autoritetet përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore”, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.**

Për këtë pikë subjekti “KRIJON” sh.p.k, nuk paraqiti raportet e auditit ligjor të pasqyrave financiare vjetore për vitin 2024 megjithëse këto dokumentet janë përcaktuara shprehimisht në dokumentat e tenderit si dokumente të detyrueshme për kualifikim për tu paraqitur.

Konkretisht referuar pasqyrave financiare të paraqitura për vitet 2023 dhe 2024 “KRIJON” sh.p.k, për dy vite rradhazi plotësonte dy nga tre kushtet kumulative të përcaktuara në nenit 41, të ligjit

nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar:

a). totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh;

KRIJON sh.p.k në vitin 2023 rezulton me aktive 344,000,000 (treqind e dyzetë e katër milion) lekë .

KRIJON sh.p.k në vitin 2024 rezulton me aktive 361, 000,000 (tre qind e gjashtëdhjetë e një milion) lekë

b)ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh; iii. ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël.”

KRIJON sh.p.k në vitin 2023 rezulton me qarkullim financiar 417,492,598 (katër e shtatëmbëdhjetë milion e katërqind e nëndhjetë e dy mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë .

KRIJON sh.p.k në vitin 2024 rezulton me aktive 310,538,319 (treqind e dhjetë milion e pesëqind e tridhjetë e tetë e treqind e nëntëmbëdhjetë)lekë

Në zbatim të rregullave në Shtojcën 8 , Kërkesat e Veçanta për Kualifikim, paragrafi i fundit ku përcaktohet “*Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim*”, oferta e subjektit KRIJON sh.p.k refuzohet për mosparaqitjen e dokumentit të kërkuar mbi raportin e auditit financiar për bilancin e vitit 2024.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “**MEDFAU” shpk**, me adresë: *Tirane Kavaje KAVAJE LAGJA 5*, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 12,900,000 (dymbëdhjetë milion e nëntëqind mijë) Lekë pa TVSH është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR